



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1268/Prot.  
2

Tiranë, më 19.01 2016

**Lënda:** Mendim për projektin koncesionar të implementimit të sistemit të targave me çip (RFID).

**Drejtuar:** Z. Edmond HAXHINASTO, MINISTËR

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

**Adresa:** Sheshi Skënderbej 5, Tiranë 1000, AL

**TIRANË**

I nderuar zoti Ministër,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.Prot.6277 datë 07/12/2015 dhe në vijim të dy takimeve të zhvilluara pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit me përfaqësues të Ministrisë dhe të subjektit koncesionar "Porta Saber Albania" sh.p.k., lutemi referohuni në vijim në interpretimin ligjor përkatës.

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar por edhe rregullave ndërkombëtare në këtë drejtim (Rekomandimi i datës 12.05.2009 i Komisionit Europian "Mbi zbatimin e principeve të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave në aplikacionet e mbështetura në RFID") në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale:

1. Kontrolluesi duhet të hartojë dhe publikojë një informacion të saktë lidhur me sistemin RFID ku minimalisht duhet përfshirë:
  - Identiteti dhe adresa e kontrolluesit.
  - Qëllimi i sistemit.
  - Çfarë të dhënash personale përpunohen nga sistemi.
  - Një përmbledhje e masave të sigurisë së sistemit.
  - Nëse aplikimi i këtij sistemi sjell ndonjë rrezik për privatësinë e individit dhe masat që vetë ai mund të marrë për të zbutur këto rreziqe.

Subjekti i të dhënave duhet të vihet në dijeni për informacionin më sipër në kohën e duhur, përpara vënies në funksionim të sistemit.

2. Kontrolluesi duhet të parashikojë informacionet e mëposhtme lidhur me sistemin e tij:
  - Emërtimi, qëllimi i sistemit dhe shtrirja gjeografike e tij.
  - Mënyra si do të funksionojë sistemi, komponentët dhe teknologjia e përdorur.
  - Përdoruesit/individët që do preken nga sistemi.
  - Tipi i të dhënave personale që përpunohen dhe koha e ruajtjes së tyre.
  - Qëllimi i përhapjes të të dhënave personale në palë të treta,
3. Kontrolluesi duhet të sigurojë implementimin e masave mbi sigurinë e informacionit, duke ju referuar në mënyrë të veçantë Udhëzimit Nr.21 të Komisionerit për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj". Kontrolluesi duhet të caktojë një person ose grup personash përgjegjës për shqyrtimin e vazhdueshëm të masave teknike dhe organizative të ndërmarra për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Kontrolluesi përgjatë aktivitetit të përpunimit të të dhënave, duhet të kufizojë rreziqet e ndryshme mbi privatësinë, duke përfshirë (por jo vetëm) rastet kur:
  - Përpunimi i të dhënave personale nuk është i bazuar në pëlqim, një kontratë apo detyrim ligjor. Psh. operatori i sistemit ndan të dhënat e mbledhura me një palë të tretë jashtë kuadrit ligjor të përcaktuar.
  - Qëllimi i mbledhjes së të dhënave nuk është saktësuar dhe dokumentuar ose për qëllimin e specifikuar mblidhen më tepër të dhëna se ç'është e nevojshme.
  - Informacioni i dhënë ndaj subjektit të të dhënave mbi qëllimin dhe përdorimin e të dhënave të tij nuk është i plotë, përpunimi i të dhënave nuk është bërë transparent, ose informacioni nuk është dhënë në kohën e duhur.
  - Të dhënat janë ruajtur më shumë se ç'është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e përcaktuar.
  - Të drejtat e aksesit të operatorëve në sistemet e kontrolluesit nuk janë revokuar, kur ato nuk janë më të nevojshme.
  - Mekanizmi i zbatuar logging është i pamjaftueshëm, psh. nuk regjistrohen proceset administrative.

Nga Zyra e Komisionerit pasi është studiuar materiali i vendosur në dispozicion në formë elektronike (CD), janë bërë disa konstatime në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e ligjit. Në lidhje me këto konstatime janë dhënë disa sqarime nga përfaqësuesit e Porta Saber Albania sh.p.k.

Në pjesën më të madhe këto sqarime kanë qënë në kuadrin që kemi të bëjmë vetëm me një projekt dhe nuk është ende produkti final.

Në lidhje me pretendimin e Porta Saber Albania sh.p.k nëse informacioni që ka lidhje me targën përbën të dhënë personale, legjislacioni shqiptar ka një përkufizim të qartë në lidhje me këtë term. Ky përcaktim bëhet në nenin 3/1 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar “ *Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social*”. Në kuptim të këtij neni, pavarësisht se çfarë mbledhet si e dhënë në momentin fillestar, nëse kjo në një moment të caktuar lidhet me identitetin e një personi fizik (drejtues automjeti psh. në rast mos pagimi taksash) pavarësisht, nëse është koncesionari apo autoriteti kontraktor që zbulon identitetin, kjo përbën një të dhënë personale. Në këtë kuadër duhen përcaktuar të gjitha dispozitat që parashikon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale nga palët implementuese.

Në takimet e zhvilluara dhe nga përgjigja e Porta Saber Albania në lidhje me disa parashtrime në lidhje me projekt/propozimin, të dërguar për mendim, sqarohet se elemente të plota në lidhje me mbrojtjen e privatësisë do të përcaktohen në aktin që do të miratojë koncesionin (ligj, VKM), Kontratën Koncesionare midis palëve, Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Reflektimi i parashikimeve dhe procedurat e sipërpërmendura, do të mund të sjellin projektin në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, në zbatim të nenin 31 pika 1/a të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, aktet e mësipërme, të cilat do të vendosin rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, duhen dërguar për mendim pranë Zyrës së Komisionerit përpara miratimit të tyre.

Faleminderit për vëmendjen,

